SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "ALBCONTROL" SH.A. është krijuar si shoqëri aksionere me vendimin nr.20717, datë 03.02.1999 të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Aksioner i vetëm i shoqërisë që zotëron 100% të kapitalit aksionar është Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Kapitali aksionar është 5.953.141.000 lekë i ndarë në 5.953.141 aksione me vlerë nominale 1.000 lekë/aksion.

Shoqëria zhvillon aktivitetitn e saj në Shqipëri, me adresë Aeroporti "Nënë Tereza", Rinas, PO BOX 7182. Ajo është e rregjistruar pranë organeve tatimore me NIPT J61908011H dhe në datën 31.12.2020 ka 309 punonjës (31 dhjetor 2019: 329 punonjës)

Misioni i shoqërisë është të ofrojë shërbime të lundrimit ajror në hapësirën shqiptare (FIR), në kushtet e parrezikshmërisë, cilësisë, kujdesit ndaj mjedisit dhe i orientuar ndaj klientit. Shërbimi i lundrimit ajror ofrohet për avionët që ulen e ngrihen në aeroportin ndërkombëtar "Nënë Tereza", Rinas si dhe për avionët që mbikalojnë hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë.

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë rregullohet sipas përcaktimeve të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar); ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" (i ndryshuar); ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" datë 10.05.2018; Statutit të shoqërisë "ALBCONTROL" SHA; legjislacionit tatimor e fiskal në fuqi si dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL

2.1. Bazat e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar SNRF të lëshuara nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") të BSNK-së.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.2. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj në të ardhmen.

Në mars të vitit 2020 u shpall gjendja e pandemisë në Shqipëri dhe në botë. Masat e marra nga Qeveria Shqiptare përfshinë kufizime dhe më pas anullimet e të gjitha fluturimeve të pasagjerëve. Këto masa kanë ndikuar direkt veprimtarinë duke zvogëluar në mënyrë domethënëse të ardhurat e saj. Aktualisht shumë vende, përfshi këtu edhe Shqipërinë, kanë filluar të lehtësojnë masat e shtrëngimit dhe procesi i vaksinimit masiv ka filluar tashmë. Si rrjedhojë, edhe Shoqëria pret që këto masa të kenë një efekt pozitiv në funksionimin e saj operacional.

Edhe pse kjo situatë e krijuar do të ndikojë në fitimet e Shoqërisë për sa kohë që vazhdon, nuk përbën një kërcënim për vijueshmërinë e saj. Shoqëria ka burime të sigurta likuide për të përballuar nevojat e saj operacionale.

Për më tepër, Shoqëria ka marrë masa për të përballuar efektet e aktivitetit të reduktuar të tilla si mbajtjen në një nivel të domosdoshëm të shpenzimeve duke mos kompromentuar sigurinë e shërbimit ndaj klientit. Shoqëria pret të ketë një rritje të trafikut gjatë vitit 2021 dhe do të jetë në gjendje të mbulojë shpenzimet e saj operacionale me të ardhurat e parashikuara. Shoqëria është operatori i vetëm operacional në Shqipëri dhe për rrjedhojë nuk mban risqe për vazhdueshmërinë e tij. Për më tepër, ALBCONTROL SHA kërkohet të jetë operacional gjatë gjithë kohës. Kështu që, pasqyrat financiare vijojnë të përgatiten duke mbajtur parasysh parimin e vijueshmërisë.

2.3. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në monedhën shqiptare LEK e cila është monedha funksionale e shoqërisë.

2.4. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale (Lek) me kursin e këmbimit në datën në të cilën ndodh transaksioni. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale (Lek) me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë të datës së raportimit të Pasqyrave Financiare. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.4. Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

funksionale në fillim të periudhës e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivet dhe detyrimet jo – monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale (Lek) me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë.

Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, përveç diferencave të këmbimeve për huamarrjet në monedhë të huaj të lidhura më aktivet në ndërtim për përdorim të ardhshëm, të cilat përfshihen në kostot e këtyre aktiveve kur ato lidhen me një rregullim në koston e interesit të huamarrjeve në monedhë të huaj.

Kurset e këmbimit në lekë me monedhat e huaja për periudhat respektive janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
LEK / EUR	123.70	121.77
LEK / USD	100.84	108.64
LEK / GPB	137.93	143.00

2.5. Instrumentat financiarë

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

i) Aktivet financiare

Klasifikimi dhe matjet pasuese – kategoritë e matjes. Kompania klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivit.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.5. Instrumentat financiarë (vazhdim)

i) Aktivet financiare (vazhdim)

Klasifikimi dhe matjet pasuese – modeli i biznesit. Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Kompanisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjetesh monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet individuale financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Kompania ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.

Klasifikimi dhe matjet pasuese – karakteristikat e flukseve monetare. Kur modeli i biznesit është mbajtja e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për ti shitur, kompania vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, kompania konsideron nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie,
aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 5 për gjykimet kritike të aplikuara nga Kompania në kryerjen e provës VPPI për asetet e saj financiare.

Pakësimi i vlerës. Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësia ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paaftësi paguese dhe falimentim.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.5. Instrumentat financiarë (vazhdim)

i) Aktivet financiare (vazhdim)

Kompania mund të çvlerësojë aktivet financiare që ende i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur Kompania kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

Heqja nga librat kontabël. Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet financiare ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi fillestar"), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësive ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivit financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk man thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

ii) Detyrimet financiare

Kategoritë e matjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matur me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

Heqja nga librat kontabël. Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhen (dmth. Kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon). Diferenca në balancat e mbetura njihet në pasqyrën e fitimeve dhe humbjeve.

iii) Kompensimi i instrumentave financiarë.

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohet shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paaftësisë së pagesës ose falimentimit.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.5. Instrumentat financiarë (vazhdim)

iii) Kompensimi i instrumentave financiarë (vazhdim)

Kompania zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të Kompanisë maten me koston e amortizuar. Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbehet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshmohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit. Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principalit, plus interesin e përllogaritur, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë për aktivet financiare.

Instrumentat financiarë jo derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiare jo derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç sa përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çrregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë, pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çrregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë mjetet monetare në arkë, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në bankë. Për qëllime të fluksit të mjeteve monetare dhe jo vetëm, këtu përfshihen edhe depozitat në formën e garancisë për huatë, me maturitet 3 muaj e më shumë.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.5. Instrumentat financiarë (vazhdim)

iii) Kompensimi i instrumentave financiarë (vazhdim)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar si rregull në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumentat të tjerë joderivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi. Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiar të

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.5. Instrumentat financiarë (vazhdim)

iii) Kompensimi i instrumentave financiarë (vazhdim)

rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kompensimi instrumentave financiarë

Aktivet dhe pasivet financiare kompensohen dhe paraqiten neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm nëse ekziston një e drejtë ligjore për të kompensuar shumat e njohura dhe qëllimi që shlyerja të realizohet mbi baza neto, apo të realizohet aktivi dhe të shlyhet detyrimi njëkohësisht. Kjo vlen kryesisht për balancat ndaj/dhe nga operatorët e tjerë të telekomunikacioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat shlyhen në shumën neto, në përputhje me kontratat ekzistuese.

2.6. Aktive Afatgjata Materiale

(i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale të qëndrueshme të trupëzuara, zëri "toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje, aktive në proces" paraqiten me koston e tyre historike minus zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar, përveç tokës e cila pasqyrohet me koston e blerjes dhe aktiveve në proces.

Kosto historike përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e aktivit. Kostoja e aktivit të vetë-ndërtuar përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhurdrejtpërdrejtë me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendodhjes së aktivit.

Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.6. Aktive Afatgjata Materiale (vazhdim)

material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët) më të mëdhenj të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet dhe nxjerrje jashtë përdorimit, përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Shoqëria bazuar në Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe konkretisht SNK 16 dhe SNK 36 ka bërë një rivlerësim të AAM-e deri më 31.12.2017.

Me vendimin nr.122, datë 11.10.2018 "Për rivlersimin e aseteve të shoqërisë ALBCONTROL SH.A." të Asamblesë së Aksionarit është vendosur të kryhet procesi i rivlerësimit të AAM-e deri më datë 31.12.2017 si dhe emërimi i ekspertëve vlerësues Z. Dëfrim Voda, Znj. Vullnetare Çela dhe audituesve ligjorë Z. Kristaq Ndini, Znj. Aida Maloku për të përgatitur raportin e rivlersimit të aseteve. Procesi i rivlerësimit të Aktiveve Afatgjata Materiale nga ekspertët përkatës ka përfunduar më datë 14.01.2020 dhe është miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e Aksionarit të Shoqërisë me vendimin nr.110 datë 08.09.2020 "Për miratimin e raportit të rivlerësimit të AAM-e të shoqerisë ALBCONTROL SH.A".

Efektet e procesit të rivlerësimit të AAM-e janë pasqyruar në vitin ushtrimor 31.12.2020 dhe këto efekte paraqiten si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Diferenca e rivlerësimit gjendje 31.12.2019	Diferenca rivlerësimi			Shtesat	Pakësimet		Gjendja e rezervës së rivlerësimit 31.12.2020
			Shtesat	Pakësimet	Pakësim rezerve për gjendjet 0 në llogarin fitime të mbartura	Në llogarinë diferenca rivlerësimi	Në llogarinë fitim humbje	Zvogëlon diferencën ekzistuese	
1	211_Toka	123,958,777	271,612,300	28,269,160	10,508,777	271,612,300	28,269,160	1,440,000	383,622,300
2	212 Ndertesa		31,642,195	9,841,081		31,642,195	9,841,081		31,642,195
3	213_Makineri dhe paisje etj		2,120,760	2,368		2,120,760	2,368		2,120,760
4	213.2 -Radaret		4,684,400	2,060,971		4,684,400	2,060,971		4,684,400
5	215 Mjete transporti		0	18,200,131		0	18,200,131		0
6	218_Paisje zyre		0	12,152,464		0	12,152,464		0
7	218.2 Paisje informatike		0	5,286,403		0	5,286,403		0
8	218.9 -Sofware		0	178,352,428		0	178,352,428		0
xx	TOTALI	**123,958,777**	**310,059,655**	**254,165,006**	**10,508,777**		**254,165,006**		**422,069,655**

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.6. Aktive Afatgjata Materiale (vazhdim)

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi është llogaritur duke përdorur metodën lineare me normat manaxheriale, në mënyrë që kosto e çdo aktivi afatgjatë të trupëzuar të shpërndahet në mënyrë të njëtrajtshme (barabartë) përgjatë gjithë jetës së tij të dobishme. Amortizimi nuk aplikohet për tokën dhe aktivet në proces.

Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata të trupëzuara për periudhën ushtrimore 31.12.2020 ka ndryshuar. Në zbatim të vendimit nr.110 datë 08.09.2020 "Për miratimin e raportit të rivlerësimit të AAM-ve të shoqerisë ALBCONTROL SH.A", bashkë me procesin e rivlerësimit të AAM–ve u rishikua dhe jeta e dobishme e aktiveve afatgjata të trupëzuara dhe për vitin ushtrimor 2020 jeta e dobishme është si më poshtë:

	Jeta e dobishme
Ndërtesat	10-30 vjet
Makineri dhe pajisje	10-15 vjet
Mjete transporti	10 vjet
Pajisje informatike	6-8 vjet
Mobilje dhe orendi	10-15 vjet

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe ndryshohen në rast se efektet janë materiale.

(iv) Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit ushtrimor të vitit.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.7. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime, për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

2.8. Inventarët

Inventarët njihen me vlerën më të vogël mes kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera e realizueshme neto është çmimi i përllogaritur gjatë rrjedhjes normale të biznesit minus kostot e përllogaritura për përfundimin dhe realizimin e shitjes. Kostot e inventarit janë përllogaritur duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshin shpenzimet e kryera gjatë blerjes së inventarit dhe dërgimit të tyre në kushtet dhe vendodhjen ekzistuese.

2.9. Zhvlerësimi

Shoqëria vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësimin e aktiveve. Në rast se evidentohen tregues të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Për aktivet jomateriale që nuk janë të gatshme për përdorim, vlera e rikuperueshme përllogaritet në çdo datë të bilancit. Siç është përshkruar në shënimin 2.6*(i)* për periudhën ushtrimore 31 dhjetor 2020 janë pasqyruar efektet e rivlerësimit të AAM-e më 31.12.2017.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet atëherë kur vlera e mbartur e aktivit apo njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësi gjeneruese e parasë është njësia më e vogël e identifikueshme e grupit të aktiveve e cila gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi apo një njësie që gjeneron flukse paraje është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Për të vlerësuar vlerën në përdorim, flukset e ardhshme monetare të çmuara aktualizohen duke përdorur normën para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun specifik të aktivit.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.10. Përfitimet e punonjësve

Shoqëria në rrjedhën normale të biznesit të saj, paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonësve të saj në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritet fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirimit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar. Shoqëria ofron format e mëposhtme të përfitimeve për punonjësit e saj:

(i) Kontributet e detyrueshme per sigurimet shoqërore e shëndetësore
Shoqëria paguan kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të cilat sigurojnë benefite pensioni për punonjësit në moshën e pensionit. Instituti i Sigurimeve Shoqërore është përgjegjës për vendosjen e minimumit të detyrueshëm ligjor për pensionet sipas planit të përcaktuar të pensioneve, i cili është i detyrueshëm. Kontributet e Shoqërisë regjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (fitim ose humbje) kur ndodhin.

(ii) Leje vjetore e paguar
Të gjithë punonjësit kanë të drejtën e lejes vjetore të paguar bazuar në legjislacionin aktual.

(iii) Plani privat i pensionit për punonjësit
Shoqëria paguan në skemën e pensionit vullnetar për përfitime suplementare të punonjësve të saj. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë ndaj planit të pensioneve regjistrohen nën zërin "Shpenzime personeli", duke ndikuar kështu në pasqyrën e fitimit ose humbjes së Shoqërisë, pa patur detyrime të ardhshme për Shoqërinë.

2.11. Provigjonet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor konstruktiv i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provigjonet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provigjonet rimerren.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.12. Të ardhurat

Të ardhurat njihen në masën që është e mundur që përfitime ekonomike do të hyjnë në shoqëri dhe që të ardhurat mund të maten në mënyrë të besueshme, pavarësisht se kur bëhet pagesa. E ardhura matet me vlerë të drejtë të shpërblimit të marrë për shërbimin e kryer dhe mallrat e shitura, neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe zbritje të mundshme të shitjeve.

2.13. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jorregullisht gjatë rrjedhjes normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë fitim/humjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjatë të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit, diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

2.14. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e fillimit te kontrates. Kostot financiare rregjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria nuk ka asnjë kontratë aktive për tu trajtuar nën kërkesat e SNRF 16.

2.15. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interest efektiv.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.16. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël i tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15% (2019:15%).

Tatimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatim fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet nga diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të politikave kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipasmetodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore. Gjendja e shtyrë tatimore matet me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat priten të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anullohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

2.17. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe menaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE

3.1. Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre qëndrimeve. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme.

3. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE (VAZHDIM)

3.1. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.
Informacionet në lidhje me zonat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimit kritik në aplikimin e politikave kontabël të cilat më së shumti ndikojnë në paraqitjen e shumave në pasqyrat financiare, janë paraqitur në shënimin nr. 5.

3.2. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Shifrat krahasuese rregullohen konform ndryshimit në paraqitje për periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

3.3. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave. Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkaktimin e një sistemimi material në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.

Tatimi mbi fitimin
Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerën e tatimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar fiskal është i pasigurt. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumat të cilat janë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në aktivet dhe detyrimet aktuale ose të shtyra të tatim fitimit në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë.

Jeta e dobishme për aktivet afatgjata materiale
Siç është përshkruar në shënimin 2.6.*(iii)* Drejtimi i Shoqërisë ka rishikuar dhe vlerësuar jetën e dobishme të pronave, makinerive dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportuese. Gjatë vitit aktual, Drejtimi ka vendosur që jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale të ndryshoj.

3. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE (VAZHDIM)

3.3. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit (vazhdim)

Vlerësimi i modelit të biznesit

Modeli i biznesit orienton klasifikimin e aktiveve financiare. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjes, Kompania konsideron frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsyet për shitjet dhe pritjet për aktivitetin e shitjeve të ardhshme. Transaksionet e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të rrezikut të kredisë mund të jetë në përputhje me modelin e biznesit objektivi i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale. Shitjet e tjera para maturimit, jo të lidhura me aktivitetet e administrimit të rrezikut të kredisë, janë gjithashtu në përputhje me modelin e biznesit objektivi i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, me kusht që ato të jenë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht dhe në tërësi.

Kompania vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes që nga fillimi i aktivitetit të saj të shitjes. Modeli i biznesit "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur" nënkupton që mjetet janë mbajtur për të mbledhur flukset e mjeteve monetare, por shitja është gjithashtu pjesë integrale për arritjen e objektivit të modelit të biznesit, siç janë menaxhimi i nevojave të likuiditetit, arritja e një kthimi të caktuar ose përputhja e kohëzgjatjes së aseteve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto asete. Gjatë kalimit në SNRF 9, kompania identifikoi se:

- Rreziqet kryesore të modelit të biznesit janë në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale" me fokus në rrezikun e kredisë. Asnjë peshë nuk jepet për çmimin ose rrezikun e vlerës së drejtë;
- Deri më tani nuk ka pasur asnjë shitje aktivit financiar. Shitjet do të ndodhin vetëm në përgjigje të përkeqësimit të rrezikut të kredisë nga pala tjetër, që rezulton nga shkeljet e kritereve të brendshme të rrezikut të kredisë. Këto shitje do të ishin në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale". Një shitje për shkak të plotësimit të nevojave të likuiditetit do të ishte rastësore. Prandaj, modeli i biznesit që lidhet me Llogaritë e Arkëtueshme konsiderohet të jetë "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale".

Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare janë vetëm pagesa principali dhe interesit ("VPPI")

Përcaktimi nëse flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar janë vetëm pagesa principali dhe interesi kërkon gjykim.

3. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE (VAZHDIM)

3.3. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit (vazhdim)

Të arkëtueshmet tregtare të Kompanisë përfshijnë një fluks të vetëm të parasë, pagesën e shumës që rezulton nga një transaksion në fushën e zbatimit të SNRF 15, që konsiderohet të jetë principali. Rrjedhimisht, flukset monetare që rrjedhin nga të arkëtueshmet plotësojnë testin VPPI të pagesave të principalit dhe interesit pavarësisht se përbërësi i interesit është zero.

Matjet e humbjeve të parashikuara të kredisë

Niveli i humbjeve nga zhvlerësimi llogaritet për llogaritë e arkëtueshme të matura me koston e amortizuar. Meqenëse të arkëtueshmet tregtare nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi, niveli i humbjeve do të llogaritet bazuar në humbjet e pritshme të kreditit. SNRF 9 lejon përdorimin e një matricë provizionesh në të cilën llogariten kostot e zhvlerësimit për llogaritë e arkëtueshme të vjetra ose të vonuara.

4. STANDARDET E REJA DHE AMENDIMET

4.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Disa ndryshime dhe interpretime zbatohen për herë të parë në vitin 2020, por nuk kanë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë, përfshirë ndryshimin e SNK 1, i cili përshkruhet në disa detaje më poshtë. Shoqëria nuk ka miratuar herët ndonjë standard, interpretim ose ndryshim që është lëshuar, por nuk janë ende efektive.

- **SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare dhe SNK 8 Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet: Përkufizimi i 'materialit' (Ndryshimet)**

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020 dhe janë të lejueshme për t'u zbatuar më herët. Ndryshimet sqarojnë përkufizimin e materialit dhe mënyrën se si duhet të zbatohet.

Në përkufizimin e ri thuhet se, 'Informacioni është material nëse mungesa, paraqitja e gabuar ose e paqartë, ka pritshmëri të arsyeshme që të ndikojë në vendimet që përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare të përgjithshme mund të marrin në bazë të atyre pasqyrave financiare, të cilat japin informacion financiar rreth një njësie ekonomike të caktuar'.

Për më tepër, shpjegimet që shoqërojnë përkufizimin janë përmirësuar. Ndryshimet gjithashtu sigurojnë që përcaktimi i materialit është konsistent në të gjithë Standardet e SNRF-ve.

4. STANDARTET E REJA DHE AMENDIMET (VAZHDIM)

4.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale (vazhdim)

Drejtimi ka bërë një vlerësim të efektit të standardit dhe konsideron se standardi i ri nuk ka efekt në pasqyrat financiare të shoqërisë. Standardet, ndryshimet dhe përmirësimet e reja në vijim janë bërë efektive në 1 Janar 2020 megjithatë nuk janë të zbatueshme për Shoqërinë.

- Ndryshimet në SNRF 3: Kombinimet e Biznesit,
- Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7: Reforma e Vlerësimit të Normës së Interesit,
- Ndryshimet në Kuadrin Konceptual të SNRF-ve

- **IFRS 16 Qiratë – Marrëveshje qiraje të lidhura me Covid-19 (Ndryshim)**

Ndryshimi zbatohet, në retrospektivë, për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë në ose pas 1 qershorit 2020. Zbatimi i mëparshëm është i lejuar, përfshirë në pasqyrat financiare ende të pa autorizuara për t'u lëshuar në 28 maj 2020. IASB ndryshoi standardin për t'u krijuar lehtësi qiramarrësve në zbatimin udhëzimeve për kontabilitetin e modifikimit të qirasë për kontratat e qirasë sipas SNRF 16, që vijnë si pasojë e drejtpërdrejtë e pandemisë Covid-19. Ndryshimi siguron një lehtësim praktik që qiramarrësi të llogarisë çdo ndryshim në pagesat e qirasë që rezultojnë nga kontrata e qirasë në lidhje me covid-19 në të njëjtën mënyrë që do të llogariste ndryshimin sipas SNRF 16, nëse ndryshimi nuk ishte një modifikim i qirasë, vetëm nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- Ndryshimi në pagesat e qirasë rezulton në konsideratë të rishikuar për qiranë që është në thelb e njëjtë me, ose më pak se, shpërblimin për qiranë menjëherë para ndryshimit.
- Çdo ulje e pagesave të qirasë ndikon vetëm në pagesat që fillimisht u paguan më ose para 30 Qershorit 2021.
- Nuk ka asnjë ndryshim thelbësor në termat dhe kushtet e tjera të qirasë.

Shoqëria nuk ka ndikim nga ky ndryshim duke qenë se nuk ka marrje me qira.

4.2. Standarde dhe interpretime të publikuara, që nuk janë ende të aplikueshme

Ka një numër standardesh dhe interpretimesh të cilat janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që janë efektive në periudhat e ardhshme të kontabilitetit që shoqëria ka vendosur të mos i aplikojë më herët. Kompania planifikon ti aplikojë këto ndryshime kur të hyjnë në fuqi.

4. STANDARTET E REJA DHE AMENDIMET (VAZHDIM)

4.2. Standarde dhe interpretime të publikuara, që nuk janë ende të aplikueshme (vazhdim)

Ndryshimet që mund të jenë relevante për Shoqërinë, por nuk pritet të kenë ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të tij, janë paraqitur më poshtë:

- **SNK 1: Prezantimi i Pasqyrave Financiare: Detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata (Ndryshimet)** - efektive për periudhat raportuese që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2023
- **Reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) - SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 & SNRF 1 (Ndryshimet) – faza 2.**
- **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit; SNK 16 Aktivet afatgjata materiale; SNK 37 Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivet e Kushtëzuara si dhe Përmirësimet Vjetore 2018-2020 (Ndryshimet)**

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022 me leje të zbatimit të mëparshëm. BSNK ka lëshuar ndryshime të fushës së ngushtë në Standardet e SNRF si më poshtë:

- **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit (Ndryshimet)** azhornojnë një referencë në SNRF 3 në Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar pa ndryshuar kërkesat e kontabilitetit për kombinimet e biznesit. Standarti nuk është i aplikueshëm për Shoqërinë.
- **SNK 16 Ndërtesat, Impiantet dhe Pajisjet (Ndryshimet)** ndalojnë që një Shoqëri të zbresë nga kostoja e aktiveve afatgjata materiale shumat e marra nga shitja e aktiveve të prodhuar ndërsa shoqëria është duke përgatitur aktivin për përdorimin e tij të synuar. Në vend të kësaj, një shoqëri do të njohë të ardhurat e tilla të shitjeve dhe koston e lidhur në fitim ose humbje. Shoqëria nuk ka aktivitete të tilla.
- **SNK 37 Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivet e Kushtëzuara (Ndryshimet)** specifikojnë cilat kosto përfshin një shoqëri në përcaktimin e kostos së përmbushjes së një kontrate për qëllimin e vlerësimit nëse një kontratë është me kushte rënduese. Shoqëria nuk pret të ketë ndikim të rëndësishëm nga ky ndryshim.
- **Përmirësimet Vjetore 2018-2020** bëjnë ndryshime të vogla në SNRF 1 Adoptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, SNRF 9 Instrumentet Financiarë, SNK 41 Bujqësia dhe Shembuj ilustrues shoqërues të SNRF 16 Qiratë. Këto standarte nuk kanë rëndësi të vecantë për Shoqërinë dhe nuk priten ndikime të rëndësishme.

5. RIPARAQITJA

5.1. Pasqyra e pozicionit financiar

Pasqyrat financiare për vitin 2019 janë riparaqitur dhe tabela më poshtë pasqyron riparaqitjen e bërë më 31 dhjetor 2019 për pasqyrën e pozicioni financiar.

	31 dhjetor 2019	Riklasifikime		Riparaqitur 31 dhjetor 2019
AKTIVE				
Aktivet afatgjata				
Aktivet afatgjata materiale	4,766,527,236			4,766,527,236
Aktivet afatgjata materiale të investuara	29,532,152	213,970,119	[a] [b]	243,502,271
Aktive të tjera afatgjata financiare	3,198,345			3,198,345
Investime në pjesemarrje		29,532,152	[a]	29,532,152
Aktive afatgjata te tjera	243,502,271	(243,502,271)	[b]	-
Totali i aktiveve afatgjata	**5,042,760,004**	**-**		**5,042,760,004**
Aktivet afatshkurtra				
Inventarë	17,719,288			17,719,288
Llogari të arkëtueshme tregtare	410,790,461			410,790,461
Të tjera aktive afatshkurtra	633,886,329			633,886,329
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	203,752,801			203,752,801
Mjetet monetare në arkë e në bankë	362,532,952			362,532,952
Totali i aktiveve afatshkurtra	**1,628,681,831**	**-**		**1,628,681,831**
Totali i aktiveve	**6,671,441,835**	**-**		**6,671,441,835**
KAPITALI				
Kapitali aksionar	5,953,141,000			5,953,141,000
Rezerva rivlerësimi	123,958,777			123,958,777
Rezerva të tjera	174,096,701			174,096,701
Rezerva ligjore	143,586,529			143,586,529
Fitime të mbartura	(96,320,393)			(96,320,393)
Fitimi i ushtrimit	(237,465,063)			(237,465,063)
Totali i kapitalit	**6,060,997,551**	**-**		**6,060,997,551**
DETYRIMET				
Detyrime afatgjata				
Hua afatgjata	10,228,634			10,228,634
Grante,të ardhura të shtyra e të tjera detyrime	1,743,692			1,743,692
Totali i detyrimeve afatgjata	**11,972,326**	**-**		11,972,326
Detyrime afatshkurtra				
Llogari të pagueshme tregtare	457,935,628			457,935,628
Të tjera detyrime afatshkurtra	140,536,330			140,536,330
Totali i detyrimeve afatshkurtra	**598,471,958**	**-**		**598,471,958**
Totali i detyrimeve	**610,444,284**	**-**		**610,444,284**
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	**6,671,441,835**	**-**		**6,671,441,835**

5. Riparaqitja (vazhdim)

5.1. Pasqyra e pozicionit financiar

[a] Investimi në pjesëmarrje

Shoqëria ka riklasifikuar si investime në pjesëmarrje shumën prej 29,532,152 lekë. Kjo vlerë kontributin investimin e shoqërisë Albcontrol sh.a në kapitalin e shoqërisë Air Albania. Shoqëria ka bërë riparaqitjen e kësaj vlere në përputhje me kërkesat e SNRF 12- Shpalosja e pjesëmarrjeve në shoqëri të tjera.

[b] Riklasifikimi aktiveve afatgjata të investuara

Shoqëria ka riklasifikuar si zë në pasqyrat financiare vlerën e aktiveve afatgjata të investuara në shumën prej 243,502,271 lekë. Ky investim do të matet nga shoqëria në përputhje me kërkesat e SNK-40 Aktivet afatgjata materiale të investuara.

6. Aktivet Afatgjata Materiale

	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe Pajisje	Mjete transporti	Pajisje zyre, informatike	AAM në proçes	Totali
Kosto							
Gjendja më 1 janar 2019	282,072,660	2,307,212,082	6,936,331,733	121,126,762	1,709,247,830	210,269,166	11,566,260,233
Shtesa		289,491,707	218,693,605		118,191,060	344,726,079	971,102,451
Transferime		24,316,718			76,488,755	(100,805,473)	-
Pakësime		(273,969,630)	(144,611,039)	(2,956,072)	(72,074,482)		(493,611,223)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	**282,072,660**	**2,347,050,877**	**7,010,414,299**	**118,170,690**	**1,831,853,163**	**454,189,772**	**12,043,751,461**
Rivleresimi aseteve	241,903,140	(576,283,424)	(3,963,054,131)	(58,364,524)	(715,381,893)		(5,071,180,832)
Shtesa	-	3,097,280	65,159,159	-	3,164,613	74,855,121	146,276,173
Transferime					43,783,000	(43,783,000)	-
Pakësime							-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	**523,975,800**	**1,773,864,733**	**3,112,519,327**	**59,806,166**	**1,163,418,883**	**485,261,893**	**7,118,846,802**
Amortizimi i akumuluar							
Gjendja më 1 janar 2019		692,721,406	4,743,876,269	53,178,154	864,858,091		6,354,633,920
Amortizimi i vitit		99,145,569	681,871,120	11,806,764	337,813,526		1,130,636,979
Kthim amortizimi		(935,206)	(141,915,504)	(1,196,691)	(63,999,273)		(208,046,674)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	**-**	**790,931,769**	**5,283,831,885**	**63,788,227**	**1,138,672,344**	**-**	**7,277,224,225**
Rivleresimi aseteve		(594,138,496)	(4,609,586,929)	(46,690,030)	(821,538,770)		(6,071,954,225)
Amortizimi i vitit		101,101,315	394,461,596	8,306,266	221,260,462		725,129,639
Pakësime							-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	**-**	**297,894,588**	**1,068,706,552**	**25,404,463**	**538,394,036**	**-**	**1,930,399,639**
Vlera neto kontabël							
Gjendja më 31 dhjetor 2019	**282,072,660**	**1,556,119,108**	**1,726,582,414**	**54,382,463**	**693,180,819**	**454,189,772**	**4,766,527,236**
Gjendja më 31 dhjetor 2020	**523,975,800**	**1,475,970,145**	**2,043,812,775**	**34,401,703**	**625,024,847**	**485,261,893**	**5,188,447,163**

6. Aktivet Afatgjata Materiale

Aktivet Afatgjata Materiale paraqiten në bilanc me vlerën kontabël neto 5,188,447,163 lekë. Amortizimi i aktiveve është llogaritur me metodën lineare në mënyrë që kosto e çdo aktivi të shpërndahet përgjatë gjithë jetës së tij të dobishme. Në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, amortizimi me norma manaxheriale për vitin 2020 janë paraqitur si zë i shpenzimeve më vete për shumën 725,129,639 lekë.

Për vitin ushtrimor 2020, zëri "shtesat" për Aktivet Afatgjata Materiale janë në vlerën 190,059,173 lekë që lidhet me blerjet e aktiveve gjatë vitit 2020 (në vlerën 146,276,173 lekë), si dhe me transferimin e "aktiveve në proces" të cilat janë vënë në përdorim në "aktive të trupëzuara" po gjatë vitit 2020 (në vlerën 43,783,000 lekë) dhe konkretisht:

- në llogarinë 212 "ndërtime", shtesa në total është 3,097,280 lekë, e cila vjen në zbatim të Urdhërit të Përbashkët midis Ministrisë së Infrastrukturës e Energjisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.5907/2 datë 15.10.2020 "Për kalim kapital të aktiveve afatgjata materiale". Sipas këtij urdhëri bëhet kalimi kapital (pa pagesë) nga Autoriteti i Aviacionit Civil tek ALBCONTROL i aktiveve afatgjata materiale të Aeroportit të Kukësit.
- në llogarinë 213 "makineri e pajisje" shtesa në total janë 65,159,159 lekë, nga të cilat vlera prej 8,636,280 lekë vjen nga zbatimi i Urdhërit të Përbashkët midis Ministrisë së Infrastrukturës e Energjisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.5907/2 datë 15.10.2020 "Për kalim kapital të aktiveve afatgjata materiale" dhe vlera prej 56,522,879 lekë kanë të bëjnë me shtesa nga blerjet e vitit 2020;
- në llogarinë 218 "pajisje zyre & informatike" shtesa në total janë 46,947,613 lekë, nga të cilat vlera prej 975,120 lekë vjen nga zbatimi i Urdhërit të Përbashkët midis Ministrisë së Infrastrukturës e Energjisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.5907/2 datë 15.10.2020 "Për kalim kapital të aktiveve afatgjata materiale", vlera prej 2,189,493 lekë janë shtesa nga blerjet e vitit 2020 dhe vlera prej 43,783,000 lekë janë shtesa nga llogaria "aktivet në proces";
- në llogarinë 231 "aktive në proces", shtesa në total janë 74,855,121 lekë të cilat kanë të bëjnë me blerjet e vitit 2020;

Për vitin ushtrimor 2020, zëri "pakësime" për Aktivet Afatgjata Materiale në vlerën 258,875 lekë lidhet me pakësime të: llogarisë kontabile 218 "pajisje zyre & informatike" në vlerën totale 258,875 lekë, e cila vjen në zbatim të urdhërit të brendshëm nr.227 date 30.01.2020 "Për shlyerjen e detyrimit ndaj ALBCONTROL SH.A";

7. Aktive Afatgjata Materiale të Investuara

Vlera e aktiveve afatgjata materiale të investuara më 31.12.2020 është 243,502,271 lekë. Kjo vlerë përfaqëson vlerën e ndërtesës dhënë në huapërdorjeje Air Albania-s.

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Investime në aktive afatgjata financiare	243,502,271	243,502,271
	243,502,271	**243,502,271**

8. Aktive të tjera afatgjata financiare

Aktive të tjera afatgjata financiare paraqiten në bilanc me vlerën 2,531,345 lekë. Përfaqësojnë hua të dhëna punonjësve të shoqërisë. Investimi është mbajtur me kosto. Huadhëniet afatgjata më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si vijon:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Kredi për punonjësit	2,531,345	3,198,345
	2,531,345	**3,198,345**

9. Investime në pjesëmarrje

Vlera e investimeve në pjesëmarrje më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 përfaqëson kontributin e Albcontrol sh.a në kapitalin e Air Albania. Shoqëria Albcontrol zotëron 10% të kapitalit të shoqërisë Air Albania.

Pasqyrat financiare të shoqërisë Air Albania për vitin 2020 nuk janë publikuar deri në momentin e hartimit të pasqyrave financiare dhe shënimeve shpjeguese. Si rezultat pjesëmarrja nuk është korigjuar me rezultatin e pasqyrave finaciare të shoqërisë Air Albania të vitit 2020.

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Pjesëmarrje në shoqëri të tjera	29,532,152	29,532,152
	29,532,152	**29,532,152**

10. Inventarë dhe aktive afatshkurtër

Inventarët, sipas llogarive të detajuara paraqiten më 31 dhjetor 2020 dhe 2019, si më poshtë vijon:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Material ndihmës	9,379,851	9,133,348
Lëndë djegëse	5,814,957	5,673,983
Pjesë ndërrimi	969,969	2,257,250
Materiale të tjera	899,920	436,642
Materiale rikupero	218,065	218,065
Inventar i imët	-	-
	17,282,762	**17,719,288**

11. Llogari të arkëtueshme tregtare e të tjera

Balanca e llogarive të arkëtueshme tregtare të shoqërisë më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Të arkëtueshme nga klientë	661,192,713	450,216,310
Zhvlerësime për klientë	(54,131,001)	(39,425,849)
	607,061,712	**410,790,461**

Këto aktive afatshkurtra në vlerën 607,061,712 lekë përfaqësojnë, të drejtat e shoqërisë më 31.12.2020 ndaj klientëve të saj në vlerën 661,192,713 lekë, nga të cilat klientë të dyshimtë për vitin 2020 janë në vlerën 54,131,001 lekë.
Në fund të vitit 2020 ka shtesa të njohjeve për zhvlerësim të kërkesave për arkëtim të detyrimeve të klientëve mbështetur në raportin "Financial Statistics for Albanian Terminal Charges 2018 dhe 2019" dërguar nga Eurocontrol, por ka dhe pakësim të njohjeve për zhvlerësim si dhe pakësim të të drejtave ndaj të tretëve (klientëve) në vlerën 1,683,121 kjo mbështetur në njoftimin e bërë nga Eurocontrol për përfundimin e procedurës së falimentit për shoqërinë ajrore Air Valle.

Lëvizjet në zhvlerësimin e të drejtave për arkëtim paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Gjendje më 1 janar	(39,425,849)	(39,923,629)
Rimarrje për vitin	1,683,121	-
Zhvlerësimi për vitin	(16,145,346)	-
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	(242,927)	497,780
Gjendja më 31 dhjetor	**(54,131,001)**	**(39,425,849)**

12. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra janë në vlerën 131,585,264 lekë më 31 dhjetor 2020 dhe përfaqësojnë të drejtat e shoqërisë ndaj:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Parapagime për furnizime	76,345,570	83,275,511
Shpenzime të periudhave të ardhshme	55,239,694	120,477,290
	131,585,264	**203,752,801**

Shpenzime të periudhave të ardhshme, në vlerën 55,239,694 lekë më 31 dhjetor 2020 përbëhen nga shpenzime për kontrata të sigurimit të riskut ndaj palëve të treta, kontrollit shëndetësor etj.

13. Mjete monetare në arkë dhe bankë

Këto aktive paraqesin gjendjen e likuiditetit në llogaritë rrjedhëse të shoqërisë apo depozitave afatshkrurtra më 31.12.2020 në monedhë funksionale dhe në valutë si më poshtë vijon:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Mjete monetare në bankë	**960,557,978**	**361,100,791**
Në lekë	37,110,047	64,027,353
Në monedhë të huaj	923,447,931	297,073,438
Mjete monetare në arkë	**16,261**	**1,432,161**
Në lekë	15,839	115,456
Në monedhë të huaj	422	1,316,705
Likujditete në udhëtim	-	-
	960,574,239	**362,532,952**

14. Të tjera aktive afatshkurtra

Të tjera aktive afatshkurtra janë në vlerën 261,862,011 lekë më 31 dhjetor 2020 dhe përfaqësojnë të drejta të shoqërisë ndaj:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
TVSH për t'u rimbursuar	228,947,533	587,224,788
Paradhënie për punonjësit	981,007	967,864
Llogari në pritje	6,908,646	6,991,306
Debitorë të tjerë	2,054,289	2,727,695
Pagesa raportesh afatgjata	19,242	19,242
Tatime të shtyra	-	35,955,434
Tatim fitimi paguar më tepër (kompensuar)	22,951,294	-
	261,862,011	**633,886,329**

14. Të tjera aktive afatshkurtra (vazhdim)

Gjatë periudhës 2020 nga ana e shoqërisë i është kërkuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tatimpaguesit e Mëdhenj Tiranë, kthimi i shumës së papërdorur nga pagesat e tatim fitimit paraprak për periudhat janar-dhjetor 2018 dhe janar-dhjetor 2019. Me shkresën nr.prot 1688/1 datë 15.10.2020 është miratuar kërkesa për kompensimin e kësaj të drejte me Tatimin mbi të Ardhurat nga Punësimi.

15. Kapitali

Politika e shoqërisë është të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besueshmërinë e saj në organizmat ndërkombëtarë në të cilat është e anëtarësuar si dhe të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të saj në kuadër të misionit strategjik që ka.

15.1 Kapitali aksionar

Me vendimin nr.102, datë 18.11.2019 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, kapitali themeltar i shoqërisë bëhet 5.953,141,000 lekë. Kapitali aksionar (themeltar) është i regjistruar dhe i paguar shoqërisë në 5.953.141 aksione në vlerë nominale 1.000 Lekë/aksion.

	31 dhjetor 2020			31 dhjetor 2019		
	Nr. Aksioneve	Vlera nominale 1000 Lek/aksion	%	Nr. Aksioneve	Vlera nominale 1000 Lek/aksion	%
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	5,953,141	5,953,141,000	100%	5,953,141	5,953,141,000	100%

15.2 Rezerva nga rivlerësimi

Ky post i bilancit më 31 dhjetor 2020 paraqitet në vlerën 422,069,655 lekë.

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Rezerva nga rivlerësimi	422,069,655	123,958,777
	422,069,655	**123,958,777**

Me vendimin nr.122, datë 11.10.2018 të Asamblesë së Aksionarit është vendosur rivlerësimi i aseteve dhe emërimi i ekspertëve për këtë qëllim. Shoqëria më datë 14.01.2019 ka lidhur kontratën e shërbimit me nr.prot.134, me afat shërbimi prej 12 muajsh kalendarikë që nga momenti i nënshkrimit të saj. Ka përfunduar procesi i rivlerësimit të Aktiveve Afatgjata

15.2 Rezerva nga rivlerësimi (vazhdim)

Materiale nga ekspertët përkatës dhe është miratuar me vendim të Asamblesë së Aksionarit nr.110 datë 08.09.2020 "Për miratimin e raportit të rivlersimit të aktiveve afatgjata materiale të shoqërisë ALBCONTROL SHA Tiranë".

15.3 Rezerva ligjore

Ky post i bilancit më 31 dhjetor 2020 paraqitet në vlerën 143,586,529 lekë.

15.4 Rezerva të tjera

Ky post i bilancit më 31 dhjetor 2020 paraqitet në vlerën 174,096,701 lekë.

15.5 Fitimi/humbja e vitit

Ky post i bilancit më 31 dhjetor 2020 paraqitet në vlerën -182,257,148 lekë (shih më poshtë seksionin e tatim fitimit dhe tatimeve të shtyra).

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Fitime/(humbje) te mbartura	(333,785,456)	(96,320,393)
Pakesim i rezerves ekzistuese te rivlersimit	702,786,557	-
Rezultati i vitit ushtrimor	(551,258,249)	(237,465,063)
	(182,257,148)	**(333,785,456)**

16. Huatë

Ky post i bilancit më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 388,205,449 lekë

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Pjesa afatgjatë e kredisë EUROCONTROL	71,740,012	-
Pjesa afatshkurtër e kredisë EUROCONTROL	306,236,803	-
Të tjera hua (KFW)	10,228,634	10,228,634
	388,205,449	**10,228,634**

Me vendim të Asamblesë së Aksionarit nr.64 datë 16.06.2020 "Mbi dakordësinë për përfshirjen e ALBCONTROL SH.A në marrëveshjen e kredisë me Eurocontrol për përballimin e krizës së shkaktuar nga Covid-19" është bërë e mundur marrja e një huaje në vlerën 3,610,483 Euro. Shoqëria filloi shlyerjen e principalit pas katër muajve nga data e marrëveshjes, më datë 02.11.2020. Principali shlyhet me këste mujore fikse duke filluar nga data 02.11.2020 deri në datën e maturimit 02.03.2022.

16. Huatë (vazhdim)

Përqindja e interesit e cila i paguhet Eurocontrol është Euribor 3 mujor +1.5%. Huaja është garantuar nga Qeveria e Shqipërisë. Më datë 31 dhjetor 2020 shuma totale e mbetur e principalit të disbursuar është paraqitur në vlerën 358,700,056 Lek (2,899,758 Euro).

17. Tatimi i shtyrë

Ky post i bilancit më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 66,690,094 lekë. Meqënëse shoqëria zbaton Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, është përllogaritur edhe detyrimi tatimor i shtyrë për shkak të diferencave të përkohëshme midis bazës kontabël dhe bazës tatimore të vlerësimit të elementëve të bilancit pasi shoqëria përdor norma amortizimi manaxheriale të cilat janë të ndryshme nga normat e amortizimit fiskal. Ky post i bilancit është përllogaritur dhe paraqitet si më poshtë vijon:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Baza kontabël e vlerësimit të AAM	4,145,119,502	4,030,264,804
Baza tatimore e vlerësimit të AAM	3,716,006,805	4,289,327,611
Diferenca e përkohshme	429,112,695	(259,062,807)
Tatim fitimi i shtyrë nga rivlerësimi	**64,366,904**	**(38,859,421)**
Baza tatimore e vlerësimit të subvencioneve	15,487,930	19,359,912
Baza kontabël e vlerësimit të subvencioneve	-	-
Diferenca e përkohshme	15,487,930	19,359,912
Tatim fitimi i shtyrë nga rivlerësimi	**2,323,190**	**2,903,987**
Total detyrime për tatim fitimi të shtyrë	**66,690,094**	**(35,955,434)**

Rakordimi dhe lëvizjet në tatimet e shtyra paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Gjendja më 1 janar	(35,955,434)	9,514,538
Shpenzime tatimi të shtyrë	102,645,528	-
Të ardhura nga tatimi i shtyrë	-	(45,469,972)
Gjendja më 31 dhjetor	**66,690,094**	**(35,955,434)**

18. Të ardhura nga grantet

Ky post i bilancit më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 1,391,342 lekë dhe ka të bëjë me grante të marra nga shteti për blerjen e pajisjeve specifike për aktivitetin e shoqërisë si dhe aktive të marra pa pagesë.

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Grante për PC falas nga EAD	122,949	158,201
AAM të marra pa pagesë	1,268,393	1,585,491
	1,391,342	**1,743,692**

19. Llogari të pagueshme tregtare e të tjera

Ky post i bilancit më 31.12.2020, paraqitet në vlerën 414,625,397 lekë dhe përfaqëson detyrimet e shoqërisë ndaj furnitorëve, të drejta të klientëve, etj.

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Llogari të pagueshme tregtare	394,347,770	416,185,627
Kosto e AAC-së për en-route	20,277,628	41,750,001
	414,625,398	**457,935,628**

Llogari të pagueshme tregtare e të tjera përbëhet nga furnitorë të llogarisë 401 në vlerën 213,444,592 lekë, furnitorë të llogarisë 403 në vlerën 20,277,628 lekë, furnitorë të llogarisë 404 në vlerën 180,903,177 lekë.

20. Tatimi mbi fitimin

Ky post i bilancit më 31 dhjetor 2020, paraqitet në vlerën 0 lekë pasi shoqëria për periudhën ushtrimore viti 2019 dhe për periudhën ushtrimore viti 2020 rezulton me humbje.

21. Detyrime financiare të tjera

Ky post i bilancit paraqitet në vlerën 60,829,898 lekë dhe përfaqëson detyrime të shoqërisë ndaj punëmarrësve të saj, detyrime për paga, detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, tatim të mbajtur në burim, etj.

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Detyrime për sig. shoqërore & shëndetësore	7,715,393	11,164,910
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	3,842,544	12,416,404
Detyrime për sigurimin vullnetar	-	3,397,030
Paga për tu paguar	27,787,562	63,903,184
Detyrime të tjera	8,775,719	3,991,136
Dividentë për t'u paguar	-	14,358,590
Llogari në pritje	12,708,680	31,305,076
	60,829,898	**140,536,330**

22. Të ardhurat

Të ardhurat janë fluks bruto të përfitimeve ekonomike të cilat gjenerohen përgjatë ecurisë normale të aktivitetit të biznesit. Të ardhurat nga operacionet, të ardhurat e shoqërisë përbëhen kryesisht nga shërbimi i lundrimit ajror (terminal & en-route) si dhe të ardhura të tjera nga shërbimi i Sallës VIP, të ardhura nga qiraja etj. Të ardhurat janë njohur dhe kontabilizuar sipas parimit të të drejtave të konstatuara, janë reflektuar në pasqyrat e shoqërisë të cilat analizohen më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Shitje nga shërbimi	1,749,757,021	3,557,510,034
Qira ambjentesh	291,000	444,000
Shitje në Salla VIP	197,333	257,720
Shitje bari ACC	336,283	1,965,400
Të ardhura IOLP	5,290,727	2,094,578
Të ardhura publikime AIP	134,343	503,567
	1,756,006,707	**3,562,775,299**

23. Të ardhura të tjera

Të ardhura të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Penalitete dhe gjoba	-	485,122
Të ardhura të tjera rrjedhëse	66,751,726	480,339
	66,751,726	**965,461**

Gjatë periudhës 2020 Shoqëria ka ulur llogarinë në pritje pas rakordimit të bërë me Drejtorinë Rajonale Tatimore Tatimpaguesit e Mëdhenj Tiranë, për pagesat e tatim fitimit paraprak për periudhat janar-dhjetor 2018 dhe janar-dhjetor 2019, ky sistemim është shoqëruar me veprime kontabël në llogarinë e të ardhurave.

24. Shpenzime për lëndë të para dhe materiale të konsumueshme

Shpenzimet për lëndë të para dhe materiale të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë detajuar si më poshtë

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Lëndë ndihmëse	303,646	3,606,664
Lëndë djegëse	19,543,960	23,990,545
Pjesë ndërrimi	432,738	7,113,640
Blerje energji	19,576,027	25,582,588
Blerje materiale zyre	4,079,793	7,432,880
Blerje materiale të tjera	2,589,507	4,957,038
	46,525,671	**72,683,355**

25. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë në vlerën 710,622,936 lekë.

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Paga personeli	530,723,211	859,831,792
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	61,642,126	78,646,843
Shpenzime të tjera për personelin (shpërblime)	18,786,653	140,240,133
Shpenzime të tjera për personelin (trajnime)	50,868,486	136,684,184
Shpenzime të tjera për personelin	48,602,460	117,993,165
	710,622,936	**1,333,396,117**

26. Zhvlerësimi llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi llogarive të arkëtueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020, paraqitet si vijon:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Rimarrje borxhi keq	1,683,121	52,947
	1,683,121	**52,947**

27. Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 dhe 2019, detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Shpenzime mirëmbajtje	236,475,673	347,968,415
Sigurime	138,152,135	230,305,961
Shpenzime roje private	12,533,192	12,765,192
Shpenzime qiraje	23,015,984	23,531,710
Shpenzime anëtarësimi	119,550,625	124,807,138
Kontrolli i fluturimeve	8,338,080	8,447,960
Udhëtime e dieta	15,015,156	99,224,559
Shpenzime ligjore dhe konsulenca	14,735,725	49,206,601
Shpenzime për çertifikim	39,700,000	33,200,000
Shpenzime komunikimi dhe internet	19,892,964	8,210,169
Tatime dhe taksa	71,238,464	172,087,704
Komisione dhe tarifa bankare	3,882,170	2,101,672
Gjoba dhe dëmshpërblime	1,982,511	10,219,432
Shpenzime për vlerën kontabël neto	-	12,530,127
Shpenzime honorare për organet drejtuese	2,423,278	2,423,280
Shpenzime per audituesit e pasqyrave financiare	7,500,000	6,000,000
Humbje borxhi keq	1,683,121	-
Provigjone	16,145,346	40,124
Të tjera shpenzime	13,449,787	112,116,303
	745,714,211	**1,255,186,347**

28. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga fondet e investuara në depozita bankare dhe fitimet nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen dhe përllogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Kostot financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë, humbjet nga kursi i këmbimit dhe humbjet nga zhvlerësimet. Të gjitha kostot e huave njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Humbjet apo fitimet nga kursi i këmbimit dhe interesi janë paraqitur në vlerë neto - 45,061,819 lekë dhe paraqitet si vijon:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Fitim nga konvertimi	17,602,516	60,309,480
Humbje nga konvertimi	(59,939,743)	(111,580,836)
Shpenzime për interesa	(3,327,190)	(3,585,028)
Të ardhura nga interesa	602,598	30,439
	(45,061,819)	**(54,825,945)**

29. Tatim fitimi dhe tatimet e shtyra

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale, tatimin e shtyrë (aktive tatimore të shtyra nga diferencat e përkohshme mes vlerës kontabël të një aktivi ose detyrimi dhe bazës së tij tatimore) si dhe njihet në pasqyrën e fitim/humbjes të periudhës ushtrimore. Tatim fitimi aktual është tatimi që përllogaritet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi. Tatimi i shtyrë është llogaritur siç tregohet në shënimin 17 duke përdorur metodën e bilancit për diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore, pasi shoqëria përdor norma amortizimi të ndryshme nga normat fiskale. Shuma e tatimit të shtyrë të njohur në pasqyrën e fitim humbjes është shpenzime në masën 102,645,528 lekë.

29. Tatim fitimi dhe tatimet e shtyra (vazhdim)

Si më poshtë vijon, ju paraqesim një rakordim të fitimit para tatimit, tatim fitimin e llogaritur me normën e aplikueshme të tatimit si dhe rezultatin ushtrimor të shoqërisë për vitin 2020:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Fitimi para tatimit	**(448,612,722)**	**(282,935,035)**
Total shpenzime të panjohura	*77,447,017*	*88,419,462*
Penalitete gjoba dhe dëmshpërblime	1,982,511	11,000
Shpenzime zhvlerësimi (provizione)	16,145,346	(12,822)
Shpenzime të tjera	59,319,160	88,421,284
Fitimi para tatimit	**(371,165,705)**	**(194,515,573)**
Tatim fitimi	-	-
Detyrime tatimore të shtyra	(102,645,528)	45,469,972
Rezultati ushtrimor	**(551,258,249)**	**(237,465,063)**

Norma e tatim fitimit për vitin ushtrimor 2020 është 15% e fitimit të tatueshëm.

Për të llogaritur rezultatin neto të vitit 2020, shoqëria ka bërë sistemimet e nevojshme të përcaktuara në ligjin për tatimin mbi të ardhurat, të konsideruara si shpenzime të pazbritshme për qëllimin e përcaktimit të rezultatit fiskal.

30. Menaxhimi i riskut financiar

Shoqëria është e ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumentave financiarë:

- Risku i kredisë,
- Risku i likuiditetit, dhe
- Risku i tregut

Politikat e menaxhimit të riskut të shoqërisë janë vendosur për të identifikuar, analizuar dhe monitoruar risqet me të cilat përballet shoqëria si dhe për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtashme për zbatimin e limiteve. Shoqëria, përmes trajnimeve dhe standardeve dhe proçedurave të manaxhimit, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar, në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

➢ *Risku i kredisë*

Në sajë të limitit të volumit dhe llojshmërisë së bazës së klientëve të shoqërisë, përqëndrimet e riskut të kredisë në lidhje me llogaritë e arkëtueshme janë të limituara. Zhvlerësimi i

30. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

llogarive të arkëtueshme mbahen në shumën e konsideruar të nevojshme për të mbuluar riskun potencial në mbledhjen e tepricave të llogarive të të drejtave të shoqërisë.

- *Risku i likuiditetit*

Shoqëria gjeneron mjete monetare nga aktiviteti operacional kombëtar dhe ndërkombëtar dhe beson se risku i likuiditetit në një klimë normale nuk është domethënës.

Ndikimi në likuiditet

Volumi i financimit të shitjeve është zvogëluar së fundmi në mënyrë të ndjeshme. Këto rrethana mund të ndikojnë në aftësinë e Shoqërisë për të marrë hua të reja, nëse do të lindi nevoja.

Ndikimi në klientë dhe huadhënës

Debitorët e Shoqërisë mund të preken nga mungesa e likuiditetit, e cila mund të ndikojë në aftësinë paguese të borxheve që ata kanë ndaj Shoqërisë. Përkeqësimi i kushteve operative mund të ndikojë edhe në parashikimin e rrjedhave financiare nga ana e Drejtimit dhe përcaktimin e zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe jo-financiare. Me supozimin që një informacion i tillë është i disponueshëm,
Drejtimi ka rivlerësuar në mënyrën e duhur rrjedhjet e ardhshme të pritshme dhe vlerësimin e provigjoneve.

- *Risku i tregut*

Shoqëria për natyrën e aktivitetit që ka, përballet deri diku me riskun e kursit të këmbimit nga veprimet e saj normale, për më tepër që tendenca e kursit të euros ka qenë në rënie. Sidoqoftë ka gjendje të konsiderueshme të të drejtave nga klientët, ndërkohë që kundrejt furnitorëve nuk ka detyrime të mëdha që e ekspozojnë shoqërinë ndaj riskut të lartë të normës së këmbimit.

31. Analiza e ndjeshmërisë

Me anë të administrimit të riskut të normave të interesit dhe të pozicionit valutor, shoqëria synon të reduktojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e shoqërisë. Në një periudhë afatgjatë ndryshimet e përhershme dhe sinjifikative në kurset e këmbimit dhe normat e interesit mund të kenë ndikim në fitim. Më 31 dhjetor 2020 është vlerësuar se një ndryshim në përqindjen e normave të interesit në vlerën e Lek-ut kundrejt monedhave të tjera nuk do të ketë ndikim të konsiderueshëm në fitimin e Shoqërisë para tatimit mbi fitimin.

32. Ngjarje pas datës së bilancit

Më 31 dhjetor 2020 në datën e pasqyrave financiare dhe deri në datën e aprovimit të tyre nuk ka ngjarje rregulluese të reflektuara në pasqyrat financiare ose ngjarje që janë materialisht të rëndësishme për t'u paraqitur në këto pasqyra.

Markelian Mançellari
Hartues i Pasqyrave Financiare
Shef i Sektorit Financë-Kontabilitetit

Hantin Bonati
Drejtor i Përgjithshëm

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - ALBCONTROL SH.A - TIRANË